



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3549/ 25 prot.

Datë 24.03.2026

V E N D I M
Nr. 420/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.343/2026, datë 04.03.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-63577-10-03-2025, me objekt: “Loti 2 – F.V. pajisje për salla operacioni për nevojat e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit 55,994,333.32 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara
- Ankimues:** “Biometric Albania” SHPK me NIPT J61827062E dhe adresë: Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 53, Ap 6b, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK me NIPT L62217032L dhe adresë: Tirane, Rruga Allaman Dervishi, Pallati Classic A.M. Nr.31, Kthesa e Kamzës
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 04.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.343/2026, ku vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën me nr. ankimi elektronik A/2025/6168 dhe me nr.3549/2025 prot., datë 11.12.2025 të operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63577-10-03-2025, me objekt: “Loti 2 – F.V. pajisje për salla operacioni për nevojat e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit 55,994,333.32 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën me nr. ankimi elektronik A/2025/61689 dhe me nr.3549/1 prot., datë 11.12.2025 të operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit “Albadent Group” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.680/8 prot., datë 12.03.2026, me objekt “Njoftim mbi zbatim e Vendimit”, protokolluar me tonën nr. 3549/22 prot., datë 17.03.2026, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 343/2026 datë 04.03.2026 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e dates 11.03.2026 për rivlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.680/8 prot., datë 12.03.2026, me objekt “Njoftim mbi zbatim e Vendimit”, protokolluar me tonën nr. 3549/22 prot., datë 17.03.2026, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 343/2026 datë 04.03.2026 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e dates 11.03.2026 për rivlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës duke skualifikuar operatorin ekonomik “Albadent Group” SHPK në përputhje me konstatimet e KPP të shprehura në vendimin Nr. 343/2026 datë 04.03.2026.

II.3. Sa më sipër, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 343/2026 datë 04.03.2026 të KPP-së për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-63577-10-03-2025, me objekt: “Loti 2 – F.V. pajisje për salla operacioni për nevojat e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit 55,994,333.32 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-63577-10-03-2025, me objekt: “Loti 2 – F.V. pajisje për salla operacioni për nevojat e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit 55,994,333.32 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

